

PËRSHËNDETJE TË DASHUR QYTETARË!

Ne e dimë se teknologjia mund të duket pak e ndërlikuar, sidomos kur nuk je mësuar me të.

POR MOS U SHQETËSONI!

Ky udhëzues është krijuar për t'ju ndihmuar që të informoheni rreth shërbimeve publike online.

QËLLIMI YNË ËSHTË QË JU TË NDIHENI TË FUQIZUAR DHE TË PAVARUR NË PËRDORIMIN E TEKNOLOGJISË.

@ Ky material është prodhuar në kuadër të Projektit "Përfshirja dixhitale për OSHC - të dhe Angazhimin e Qytetarëve në Bashkëpunimin Rajonal (DIGI-CORE), me mbështetje nga SMART Balkans dhe i zbatuar nga "Qendra Sociale në Ndhim të Njerëzve në Nevojë" Fushë-Arrëz (QSNNN), Instituti Edutask, dhe Qendra për Inovacionet Sociale "Blink 42-21". Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e "Qendrës Sociale në Ndhim të Njerëzve në Nevojë" Fushë-Arrëz (QSNNN) dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA) as të konsorciumit SMART Balkans.



NJË MESAZH FRYMËZUES PËR JU:

Përdorimi i teknologjisë mund të duket sfidues në fillim, por me pak praktikë, do të bëhet pjesë e jetës suaj të përditshme. Ju keni mundësinë të bëheni pjesë e këtij revolucionit digjital, duke përdorur e-Kosova për të përmirësuar cilësinë e jetës suaj.

Mos harroni, çdo hap i vogël drejt teknologjisë është një hap i madh drejt një të ardhmeje më të mirë dhe më të lehtë për ju dhe të dashurit tuaj.

BROSHURË PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE ONLINE



ÇFARË ËSHTË E-KOSOVA DHE SI MUND T'JU NDIHMOJË?

e-Kosova është një portal qeveritar ku ju mund të merrni të gjitha shumë shërbime shtetërore në mënyrë elektronike, pa qenë nevoja të dilni nga shtëpia.

Me e-Kosova, ju mund të merrni dokumente, të aplikoni për shërbime dhe të kryeni pagesa nëpërmjet internetit, duke përdorur një kompjuter, tablet apo smartphone.

PSE DUHET TA PËRDORNI E-KOSOVA?



Lehtësi dhe Komoditet:

Nuk keni më nevojë të prisni në radhë ose të shkoni në zyrat shtetërore. Gjithçka mund ta bëni nga shtëpia.



Kursim Kohe:

Shërbimet janë të disponueshme 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Kjo do të thotë që mund t'i përdorni kur ju përshtatet më shumë.



Siguri dhe Besueshmëri:

Shërbimet online janë të sigurta dhe të mbrojtura nga teknologjitë më të fundit të sigurisë.

SI TË FILLONI ME E-KOSOVA?



Hapni një llogari:

Nëse nuk keni ende një llogari, mund ta krijoni lehtësisht duke ndjekur disa hapa të thjeshtë në faqen e e-Kosova.



Identifikohuni:

Pasi të keni llogarinë tuaj, identifikohuni për të hyrë në portal dhe për të filluar përdorimin e shërbimeve.



Zgjidhni shërbimin që ju nevojitet:

Pasi të jeni futur në portal, kërkoni shërbimin që ju nevojitet dhe ndiqni udhëzimet e thjeshta për të përfunduar kërkesën tuaj.

CILAT SHËRBIME MUND T'I MERRNI?

- Gjendja civile: certifikata, ekstrakte për ju dhe anëtarët e familjes
- Aplikime të ndryshme për nxënës, student dhe mësimdhënës
- Pagesa të tatimit në pronë
- Shtesa dhe subvencione për familje
- Kryeni pagesa elektronike
- Certifikata të ndryshme personale dhe familjare
- Regjistrime në institucione arsimore
- Kërkim të punës, aplikim për formim profesional
- Shërbime konsullore
- Aplikim për shërbime shëndetësore dhe mbrojtje sociale
- Aplikime dhe vërtetime rreth kontributeve dhe pensione
- Dokumente rreth gjendjes gjyqësore
- Certifikata, vërtetime, aplikime dhe pagesa për biznesin
- Taksat dhe tarifrat vendore
- Autorizime dhe dokumente doganore
- Leje dhe licenca
- Dokumente rreth automjeteve dhe transportit
- Veprime rreth pasurive të paluejtshme
- eKosova vazhdimisht pasurohet me shërbime të reja

SI MUND T'JU NDIHMOMJË MË TEJ?

Nuk jeni vetëm!

Nëse hasni ndonjë vështirësi, ju mund të kontaktoni ekipin tonë të mbështetjes në çdo kohë. Ata janë këtu për t'ju udhëhequr hap pas hapi.

Frymëzohuni!

Përdorimi i teknologjisë është një mënyrë për të qëndruar të lidhur dhe për të përfituar nga shërbimet e rëndësishme për të cilat keni nevojë. Ju jeni në gjendje të mësoni dhe të përmirësoni jetën tuaj përmes këtyre mjeteve.